



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës
SENATI AKADEMIK

Nr. 2648/6 Prot.

Durrës, më 18.12.2024

V E N D I M

Nr. 62, Datë 18.12.2024

P Ë R

"MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E KOMISIONIT TË PËRHERSHËM PËR MBARËVAJTJEN E VEPRIMTARISË DHE MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT NË UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës"

Në mbështetje të ligjit nr.80/2015, "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 46 "Komisionet e Përherëshme"; në Rregulloren e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës neni 17; në Statutin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës neni 23; në Vendimin Nr. 5, datë 30.11.2023 të Komisionit të Përherëshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët, si dhe në interpretimin e degës juridike, në mbledhjen e datës 18.12.2024 Senati Akademik,

V E N D O S I :

1. Miratimin e Rregullores për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Përherëshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët në Universitetin "Aleksandër Moisiu" Durrës, sipas materialit bashkëlidhur.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen:
 - Zv. Rektorët
 - Administratori
 - Drejtuesit e Njësive Kryesore
 - Komisioni i Përherëshëm për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe marrëdhënieve me studentët.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

K R Y E T A R

Prof. Dr. Shkëlqim Fortuzi





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

RREGULLORE

PËR

ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E

KOMISIONIT TË PËRHERSHËM

PËR MBARËVAJTJEN E VEPRIMTARISË DHE

MARRËDHËNIEVE ME STUDENTËT NË

UNIVERSITETIN "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

Miratur me Vendimin Nr. 62, datë 18 . 12 .2024 të Senatit Akademik

Durrës



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

Në mbështetje të ligjit, Nr.80/2015, datë 17/09/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" Neni 46 "Komisionet e Përhershme", Neni 23 i Statutit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës dhe neni 17 i Rregullores së Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës, anëtarët e Komisionit të Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët në Universitetin "Aleksandër Moisiu" miratojnë këtë rregullore për veprimtarinë e këtij Komisioni.

Neni 1
Objekti

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i strukturës, funksionimit dhe përgjegjësi të Komisionit të Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët, si dhe rregullimi i marrëdhënieve ndërmjet studentëve dhe administratës universitare.

Neni 2
Qëllimi

Kjo rregullore ka si qëllim të sigurojë mbështetje dhe përmirësim të kushteve të jetesës dhe mësimdhënies për studentët, duke krijuar një mjedis akademik që nxit bashkëpunimin efektiv ndërmjet studentëve dhe administratës universitare.

Neni 3
Baza ligjore

Kjo rregullore është hartuar në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë" dhe aktet nënligjore të dala në zbatim të tij. Ajo mbështetet në parimet dhe udhëzimet që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e institucioneve të arsimit të lartë, duke garantuar respektimin e standardeve ligjore për mbarëvajtjen e veprimtarive dhe marrëdhënieve ndërmjet studentëve dhe administratës universitare. Rregullorja synon të sigurojë një mjedis akademik të bazuar në parimet e transparencës, përgjegjshmërisë dhe bashkëpunimit institucional, në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi.

Neni 4
Fusha e veprimtarisë

Komisioni i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët vepron si një organ i përhershëm institucional, i krijuar nga Senati Akademik i Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës. Fusha e veprimtarisë së Komisionit përfshin mbikëqyrjen dhe koordinimin e marrëdhënieve ndërmjet studentëve dhe njësive përbërëse të universitetit, si dhe propozimin e masave për përmirësimin e kushteve të jetës studentore dhe mësimdhënies. Komisioni vepron në përputhje me misionin dhe politikën e universitetit, duke shmangur mbivendosjen me kompetencat e njësive të tjera.

Neni 5
Përbërja e Komisionit

1. Komisioni i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët është një organ kolegjal, i krijuar në nivel institucional me vendim të Senatit të Universitetit Aleksandër Moisiu të Durrësit (UAMD), në përputhje me përcaktimet e neneve përkatëse të Statutit të UAMD-së.
2. Komisioni përbëhet nga pesë (5) anëtarë:
 - a. Tre (3) anëtarë nga stafi akademik;
 - b. Dy (2) përfaqësues nga studentët.
3. Anëtarët e Komisionit vetëkandidohen dhe përzgjidhen nga Senati Akademik për një mandat dyvjeçar, me të drejtë rizgjedhjeje.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

4. Çdo anëtar duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara nga Senati Akademik, të cilat sigurojnë kompetencën profesionale dhe përfaqësimin e barabartë të grupeve përkatëse.
5. Në rast të përfundimit të parakohshëm të mandatit të një anëtari, Senati Akademik garanton zëvendësimin e tij brenda një afati të arsyeshëm, duke ndjekur të njëjtat procedura për përzgjedhje.
6. Procedurat për zgjedhjen, shkarkimin dhe kriteret specifike për secilin grup anëtarësh përcaktohen dhe miratohen nga Senati Akademik.

Neni 6

Mbledhja e parë të Komisionit

Rektori, në cilësinë e Kryetarit të Senatit Akademik thërret mbledhjen e parë të Komisionit të Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët. Mbledhja e parë e Komisionit është e vlefshme kur janë të pranishëm të gjithë anëtarët e tij.

Neni 7

Kryetari i Komisionit

1. Kryetari i Komisionit zgjidhet nga Senati Akademik me shumicë votash të të gjithë anëtarëve. Ai nënshkruan aktet që miraton komisioni.
2. Kryetari vendos për datën dhe orën e mbledhjeve të komisionit. Në mungesë të tij këtë funksion e ushtron nënkryetari.

Neni 8

Nënkryetari i Komisionit

1. Nënkryetari i Komisionit i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët zgjidhet nga radhët e anëtarëve studentë të Komisionit.
2. Zgjedhja e Nënkryetarit realizohet me shumicë votash të anëtarëve të Komisionit.
3. Nënkryetari përfaqëson interesat e studentëve brenda Komisionit dhe siguron lidhjen efektive ndërmjet studentëve dhe strukturave të tjera të universitetit.
4. Në mungesë të Kryetarit, Nënkryetari ushtron përkohësisht kompetencat e tij, duke siguruar vazhdimësinë e punës së Komisionit.

Neni 9

Detyrat e Sekretarit

1. Komisioni zgjedh mes anëtarëve të tij Sekretarin e Komisionit. Sekretari është përgjegjës për mbajtjen, protokollimin dhe ruajtjen e akteve të prodhuar nga komisioni.
2. Sekretari mban procesverbalin e mbledhjeve, i cili firmoset nga të gjithë anëtarët pjesëmarrës në mbledhje. Procesverbali i mbledhjes duhet të përmbajë informacion lidhur me vendin, kohën e fillimit të mbledhjes, rendin e ditës dhe ndryshimet e mundshme të ndodhura në të, anëtarët e komisionit të pranishëm ose që mungojnë, personat e tjerë të thirrur për të marrë pjesë në diskutime të vecanta, rezultatet e votimit, konkluzionet e mbledhjes si dhe çdo informacion të diskutuar gjatë mbledhjes. Sekretari ruan bllokun e procesverbaleve.

Neni 10

Detyrat dhe të drejtat e anëtarëve të Komisionit

1. Detyrat e anëtarëve të Komisionit:
 - a. Të marrin pjesë rregullisht dhe aktivisht në mbledhjet e Komisionit, duke kontribuar në arritjen e objektivave të tij.
 - b. Të respektojnë dhe zbatojnë vendimet e marra nga Komisioni në përputhje me rregulloren dhe aktet ligjore në fuqi.
 - c. Të mbrojnë dhe përfaqësojnë interesat e studentëve dhe të njësive përbërëse të universitetit në përputhje me misionin e UAMD-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

- d. Të bashkëpunojnë me njësitë e tjera të universitetit për zbatimin e politikave dhe masave të miratuara nga Komisioni.
- e. Të ruajnë konfidencialitetin e diskutimeve dhe informacioneve të trajtuara në Komision, përveç rasteve kur bëhet publikimi zyrtar sipas vendimeve të Komisionit.
- f. Të raportojnë rregullisht mbi çështjet për të cilat janë ngarkuar nga Komisioni.

2. Të Drejtat e anëtarëve të Komisionit:

- a. Të propozojnë çështje për diskutim dhe vendimmarrje në mbledhjet e Komisionit.
 - b. Të marrin informacion të plotë dhe të saktë për çështjet që trajtohen në Komision.
 - c. Të shprehin mendimin dhe votën e tyre për çdo vendim të Komisionit.
 - d. Të kërkojnë sqarime ose dokumente shtesë nga strukturat përkatëse të universitetit për të realizuar detyrat e tyre.
 - e. Të kenë akses në të gjitha burimet dhe informacionet e nevojshme për përmbushjen e përgjegjësisë së tyre.
3. Çdo anëtar që nuk përmbush detyrat e tij ose shkel rregullat e përcaktuara nga rregullorja, mund të përballë me masa disiplinore sipas dispozitave të kësaj rregulloreje dhe akteve të tjera në fuqi.

Neni 11

Mbledhjet e Komisionit

1. Komisioni mbledhet periodikisht të paktën një herë në muaj për të garantuar funksionimin e rregullt dhe efektivitetin e veprimtarisë së tij.
2. Mbledhjet thirren, organizohen dhe drejtohen nga kryetari i Komisionit. Kryetari është përgjegjës për hartimin e rendit të ditës, duke përfshirë të gjitha çështjet e propozuara për diskutim dhe vendimmarrje, si dhe për njoftimin e anëtarëve.
3. Rendi i ditës, së bashku me dokumentacionin shoqërues, u dërgohet të gjithë anëtarëve përmes postës elektronike të paktën dy ditë pune para datës së mbledhjes.
4. Përveç mbledhjeve periodike, kryetari mund të thërrasë mbledhje të jashtëzakonshme në raste urgjente ose kur paraqitet nevoja për diskutim dhe vendimmarrje të menjëhershme mbi çështje specifike.

Neni 12

Zhvillimi i mbledhjeve të komisionit

1. Mbledhjet e Komisionit zhvillohen në përputhje me rendin e ditës të hartuar nga kryetari. Çdo anëtar ka të drejtën të propozojë çështje për t'u diskutuar gjatë mbledhjes, në përputhje me misionin dhe objektivat e Komisionit.
2. Kryetari i Komisionit drejton mbledhjet dhe siguron që diskutimet të zhvillohen në mënyrë të rregullt duke respektuar kohën e caktuar për secilën çështje të rendit të ditës.
3. Çdo anëtar ka të drejtën të marrë pjesë në diskutime, të bëjë pyetje dhe të japë mendime mbi çështjet që shqyrtohen.
4. Mbledhjet e Komisionit janë të mbyllura për personat jashtë Komisionit, përveç rasteve kur është e nevojshme të ftohen persona të jashtëm për diskutim mbi çështje të veçanta.

Neni 13

Vendimmarrja

1. Vendimet në Komision merren me shumicë të thjeshtë të votave të anëtarëve të pranishëm. Çdo anëtar ka një votë dhe mund të japë mendim për çdo çështje që diskutohet.
2. Në rast të barazimit të votave, vota e kryetarit të Komisionit ka peshë vendimtare. Kryetari mund të japë udhëzime shtesë për çështje që kërkojnë interpretim të ligjit ose procedurës.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" Durrës

3. Vendimet e marra gjatë mbledhjeve të Komisionit janë detyruese për të gjithë anëtarët dhe për strukturat përkatëse të universitetit.
4. Të gjitha vendimet e miratuara në mbledhje duhet të dokumentohen në procesverbal dhe të dërgohen tek organet përkatëse të universitetit si dhe të njoftohen të gjithë anëtarët e Komisionit.
5. Anëtarët e Komisionit kanë mundësinë të kërkojnë rishikimin e një vendimi brenda një periudhe të caktuar, nëse konsiderojnë se ka pasur shkelje të procedurave ose të ligjit. Rishikimi bëhet në një mbledhje të ardhshme, ku vendimi i ri merret nga shumica e anëtarëve të pranishëm.

Neni 14

Procesverbalet

Procesverbalet e mbledhjeve duhet të hartohen nga sekretari i Komisionit dhe të përmbajnë përmbledhjen e diskutimeve dhe vendimet e marra. Blloku i procesverbaleve duhet të firmoset nga anëtarët e pranishëm dhe të ruhen për referencë të mëvonshme.

Neni 15

Funksionet e Komisionit

Komisioni i Përhershëm i Mbarëvatjtes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët ka këto funksione:

- a) Harton dhe dërgon për miratim pranë Senatit Akademik të UAMD-së Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e këtij komisioni.
- b) I propozon Senatit Akademik të UAMD-së politikat, procedurat dhe mekanizmat për mbështetjen e studentëve duke u mbështetur në legjislacioni në fuqi.
- c) Bashkëpunon me Këshillat Studentorë, Zyrën e Karrierës dhe Alumni dhe stafin akademik të UAMD-së.
- d) Ndjekë politikat e hartuara nga Senati Akademik për mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe marrëdhënien me studentët dhe merr masa për zbatimin e vendimeve të tij.
- e) I propozon Senatit Akademik mbështetje financiare dhe logjistike të projekteve dhe veprimtarive kurrikulare dhe ekstrakurrikulare të studentëve.
- f) Harton pyetësor dhe grupe diskutimi me qëllim mbledhjen e të dhënave nga studentët me bashkëpunimin e Këshillave Studentore në lidhje me problematika të ndryshme dhe propozon tek organet dhe autoritetet drejtuese të UAMD-së masa për zgjidhjen e tyre.
- g) Bashkërendon komunikimin midis njësive përbërëse të UAMD-së dhe studentëve.
- h) Kërkon informacione të ndryshme nga njësitë kryesore për problematika të studentëve.
- i) Kërkon që përfaqësues të Këshillave Studentorë të marrin pjesë në mbledhjet e Komisionit.
- j) Kërkon informacion nga organet përbërëse të institucionit për çështje dhe probleme të paraqitura nga studentët dhe organizmat e tyre.
- k) Orienton studentët që në bashkëpunim me organet drejtuese institucionale të marrin pjesë në aktivitete sociale, kulturore, akademike dhe sportive.
- l) Bashkërendon punën dhe bashkëpunon me Komisionet e tjera të Përhershme të ngritura pranë universitetit.
- m) Kryen çdo detyrë tjetër të ngarkuar nga autoritetet dhe organet drejtuese të UAMD-së në kuadër të sigurimit të mbështetjes së studentëve.

Neni 16

Raportimi

1. Komisioni paraqet në Senatin Akademik, brenda muajit janar të cdo viti akademik, raportin vjetor të veprimtarisë së tij me gjetjet dhe rekomandimet përkatëse, në përputhje me përcaktimet e nenit 17 të Rregullore s së UAMD-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU" DURRËS

2. Raporti vjetor i komisionit quhet i miratuar kur është votuar me shumicë të cilësuar të anëtarëve.

Neni 17

Instrumentat për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave

1. Komisioni për mbarvajtjen e veprimtarisë së tij përdor metoda të ndryshme për mbledhjen e të dhënave:
 - a. Harton dhe realizon anketime të studentëve që ndjekin programet e studimeve dhe të alumni lidhur me vlerësimin e didaktikës, të kurrikulës, të mësuarit etj;
 - b. Pyetje konceptuale;
 - c. Intervista;
 - d. Diskutime në grup.
2. Të dhënat e përpunuara i përcillen autoriteteve dhe organeve drejtuese të UAMD-së në kuadër të sigurimit të mbështetjes së studentëve.

Neni 18

Bashkëpunimet

1. Komisioni i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët në UAMD krijon dhe mban kontakte si dhe bashkëpunon ngushtësisht me Këshillat Studentor. Komisioni kërkon informacion nga Këshillat Studentor lidhur me problematikat dhe kërkesat e studentëve.
2. Komisioni i Mbarëvajtjes së Veprimtarisë dhe Marrëdhënieve me Studentët mund të inkurajojë dhe propozojë bashkëpunime me institucione të tjera universitare për të shkëmbyer eksperiencë të mira dhe për të mbështetur iniciativë bashkëpunimi në funksion të mbështetjes së studentëve.
3. Komisioni krijon bashkëpunime me organe vendore dhe qendrore si dhe organizata të ndryshme kombëtare dhe ndërkombëtare në kuadër të mbështetjes së studentëve të UAMD-së.

Neni 19

Dispozita kalimtare

1. Kjo rregullore hyn në fuqi menjëherë pas miratimit nga Senati Akademik i UAMD-së.
2. Në rast se dispozita të kësaj rregulloreje bien ndesh me dispozitat e Statutit ose të Rregullores së UAMD-së, përparësi kanë dispozitat e Statutit dhe të Rregullores.
3. Çdo ndryshim ose shtesë e kësaj rregulloreje bëhet sipas procedurës së miratimit të saj.

Neni 20

Miratimi i Rregullores

Kjo rregullore u miratua me vendimin nr. 62, datë 18.12.2018 të Senatit Akademik të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës dhe hyn në fuqi në datën e shpalljes së saj.